



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 28
Prishtinë, më 2.7.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Nezir Çoçaj, Driton Çausi, Arbërie Nagavci, Abdyl Salihu, Mufera Shinik, Fidan Rekaliu, Valentina Bunjaku- Rexhepi

Munguan: Albulena Balaj- Halimaj dhe Verica Çeraniq

Përfaqësues të tjerë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Rudinë Fetahaj.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 18 dhe 20 qershor 2018;**
- 3. Shqyrtim i Projektligjit numër 06L/073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91, deri në vitin shkollor 1998/99;**
- 4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime të Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**

5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 18 dhe 20 qershor, 2018;

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 18 dhe 20 qershor, 2018 u miratuan pa vërejtjen e deputetëve.

3. Shqyrtim i Projektligjit numër 06L/073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91, deri në vitin shkollor 1998/99;

Ismajl Kurteshi, tha që për shkak të rëndësisë së këtij projektligji dhe për shkak të divergjencave të ministrive të caktuara brenda qeverisë së Kosovës, Komisioni ka vendosur që edhe një herë të ftojë Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe SBASHK-un, në mënyrë që të bëhet sqarimi i të gjitha mëdyshjeve lidhur me këtë projektligj. Ai falënderoi Bankën Botërore dhe SBASHK-un për komentet e dërguara dhe tha se Komisioni do t' i marrë parasysh gjatë mbledhjeve që do t' i mbajë, në lidhje me këtë projektligj.

Agim Bërdynaj, MASHT, tha se Ministria nuk ka diçka konkrete të shtojë lidhur me projektligjin në fjalë. Ai tha se divergjencat mes ministrive nuk do të duhej të kishte dhe bëri thirrje që Komisioni t' i shfrytëzojë të gjithë mekanizmat e mundshëm që ligji në fjalë të kalojë në fillim të muajit shtator, pasi që edhe procedurat e implementimit do të marrin shumë kohë. Ai gjithashtu tha se kërkesa e tyre si ministri është që procesi të fillojë sa më parë dhe që ligji të kalojë.

Ismajl Kurteshi, tha se Komisioni do të fillojë javën e ardhshme punën e tij dhe MASHT-i si sponsor ka të drejtë të marrë pjesë aktive në diskutimet e Komisionit.

Bahri Xhaferi, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, tha se në parim ky ligj do të duhej të kalonte, mirëpo, sa i përket aspektit të përfitimit të pensioneve, ai tha se ky ligj ka mangësi të theksuara dhe privilegje të theksuara. Ai tha se përshkallëzimi në dy kategori të ndryshme, mund t' i shkaktojë shumë telashe buxhetit të Kosovës. Gjithashtu, ai shtoi se, përkundër respektit dhe mirënjohjes që meritojnë mësimdhënësit e këtyre viteve, duhet pasur parasysh edhe koston buxhetore e cila do të jetë më shumë se 6 milion që është planifikuar për vitin e ardhshëm. Ai tha se duhet të punohet më shumë për këtë projektligj si dhe të angazhohen edhe subjekte tjera. Xhaferi njoftoi të pranishmit që MPMS-ja ka formuar grupin për reformën pensionale, ku parashihet një ligj unik në të cilin do të futeshin të gjitha të drejtat e supozuara për pension dhe

ligji të jetë në harmoni me standardet evropiane dhe shtoi se mosharmonizimi i ligjeve si dhe numri i madh i ligjeve të specifikuara, mohojnë të drejtën për pension ose subvencion.

Rrahman Jashari, SBASHK, tha se nuk është e drejtë të kërkohej ridefinimi i këtij projektligji sepse do të ishte një goditje e rëndë për mësimdhënësit që të kërkohej një rikthim i ligjit pasi që ky projektligj është hartuar nga MASHT-i, ku të pranishëm kanë qenë edhe MPMS-ja dhe Ministria e Financave. Ai tha se polemikat po ndodhin vetëm kur bëhet fjalë për mësimdhënësit e atyre viteve, pasi që këto lloj pensione nuk paraqesin privilegje por të drejtën e tyre që kanë rrezikuar jetën dhe familjen për të vendosur themelin e arsimit në Kosovë.

Bahri Xhaferi, MPMS, tha se ministria nuk është kundër këtij projektligji dhe se kontributi duhet t'ju njihet dhe t'ju pranohet mësimdhënësve, mirëpo që shqetësimi më i madh i Ministrisë qëndron në përshkallëzimin e viteve si dhe në linjën buxhetore të përcaktuar nga Ministria e Financave. Ai tha se praktika në shumë raste ka treguar që ky lloj i planifikimit buxhetor nuk ka mjaftuar për implementimin e ligjeve dhe që shumë të drejta po konfrontohen njëra me tjetrën dhe shtoi se pjesa dërmuese e përfituesve të këtij pensioni nuk kanë arsimin superior shkollor dhe bëri thirrje që të kenë kujdes.

Teuta Haxhiu, tha se Komisioni është zotuar që të mbajë takime sa herë që është nevoja deri sa ligji të kalojë për herë të dytë si dhe të marrë dritën jeshile për tu zbatuar. Ajo tha se skemat pensionale nuk janë të rregulluara ashtu siç duhet dhe propozimet konkrete lidhur me përshkallëzimin e kategorive, do të ndihmojnë tej mase punën e Komisionit.

Ajo shtoi që të gjitha partitë kanë votuar pro këtij ligji dhe se nuk është etike as të mendohet që njëra nga partitë po sponsorizon fushatë kundër këtij ligji dhe kërkoi që të specifikohet saktë sa është shuma që do ta marrin përfituesit, pa e llogaritur pensionin bazë.

Bahri Xhaferi, MPMS, tha se roli i MPMS-së do të duhej të ishte më i lartë, mirëpo që forcat politike e kanë bërë të kundërtën. Ai tha se janë katër ose pesë persona të cilët kanë pasur lidhje politike dhe kanë bërë marrëveshje të iniciojnë këtë ligj, sepse sipas tij ekzistojnë shumë ligje specifike, si ai për të verbrit, për paraplegjikët etj, të cilët shkaktojnë shumë probleme gjatë zbatimit të tyre. Gjithashtu, ai shtoi që duhet gjetur një formë më e pranueshme sepse buxheti prej 6 milion për vitin 2019, sigurisht që nuk do të jetë i mjaftueshëm.

Ismajl Kurteshi, njoftoi se javën që vjen do të fillojë shqyrtimi i projektligjit dhe i ftoi ministrinë të dërgojnë komentet e tyre dhe propozimet me shkrim, kurse Ministrinë e Arsimit e ftoi të marrë pjesë aktive në takimet që do mbahen për shqyrtimin e këtij projektligji.

Kurteshi tha se komentet e Bankës Botërore dhe SBASHK-ut do të shqyrtohen në mbledhjet në vazhdim.

Arbërie Nagavci, në mënyrë që të shmangen qëllimet politike, propozoi që në emër të Komisionit t'i bëhet thirrje Ministrisë së Financave për një raport të detajuar mbi koston dhe të gjitha detajet tjera lidhur me këtë projektligj.

Nezir Çoçaj, tha se ligji tani e tutje duhet të trajtohet vetëm nga Komisioni, pasi që vizitat e Ministrive nuk po rezultojnë të suksesshme, duke marrë parasysh mungesën e komenteve dhe propozimeve konkrete nga ana e tyre.

Valentina Bunjaku -Rexhepi, tha se prania e Ministrisë së Financave është e nevojshme për shqyrtimin e këtij projektligji. Ajo tha se është shqetësues moskoordinimi i ministrive mes vete dhe se për të shmangur çdo lloj problemi, duhet të mbështetemi në shifra konkrete.

Teuta Haxhiu, tha se meqenëse Ministria e Financave po shfaq pakënaqësi, ajo duhet të sjellë amendamente shtesë që ta arsyetojnë kundërshtimin e tyre. Ajo tha se ligji duhet të jetë i zbatueshëm edhe në terma praktik.

4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime të Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;

Ismajl Kurteshi, njoftoi anëtarët e Komisionit me raportet e komisioneve të përhershme, të cilët kanë shqyrtuar dhe miratuar amendamentet e Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe nuk kanë pasur ndonjë amendament. Anëtarët e Komisionit ftohen për votim të raportit me rekomandime për dërgim në lexim të dytë në Seancë Plenare..

Të gjithë anëtarët prezent të Komisionit votuan për të proceduar këtë Projektligj në lexim të dytë.

1. Të ndryshme.

Ismajl Kurteshi, njoftoi anëtarët e komisionit që Ambasadorja e BE-së, Natalija Apostolova, ka kërkuar ta takojë Komisionin me 4 korrik, në orën 13:30 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku do të trajtohet angazhimi i BE-së në ngritjen e cilësisë në arsim.

Nezir Çoçaj, propozoi që Komisioni të realizojë një vizitë tek universitetet publike.

Teuta Haxhiu, propozoi që edhe Agjencisë së Akreditimit t'i bëhet një vizitë si dhe të kërkohet një raport publik mbi atë së çfarë ka ndodhur me Agjencinë e kaluar. Haxhiu tha se do të duhej edhe ministri i Arsimit t'i bëjë publike qëndrimet e tij karshi Agjencisë.

Arbërie Nagavci, tha se ministri i Arsimit e ka shkarkuar ushtruesin e detyrës në agjenci dhe ka punësuar dikë tjetër, kështu që do të duhej të kërkojmë raport nga vet ministri për këtë dukuri.

Ismajl Kurteshi, propozoi që në vend të vizitës në universitete, të mbahet një takim i përbashkët me rektorët e universiteteve publike në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe tha se duhet të organizohet edhe një takim me ministrin e Arsimit, në lidhje me çështjen e Agjencisë, propozime këto me të cilat u pajtuan edhe anëtarët e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Ismajl Kurteshi